

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jeshmire Org. Unit	07
Kr. Prot: Eroj Prot: Prot. No	05-1916
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 8 -
Data: Datum:	29, 03, 2023
Prishtinë / a	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH**

<b>DATË/A:</b>	28.03.2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Salvador Elmazi-Drejtor i Buxhetit-MFPT
<b>CC:</b>	Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave punës dhe Transfereve
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSh
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Znj. Kadrije Berisha, ZKF-MSh
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026- Ministria e Shëndetësisë

I nderuari z. Elmazi, Drejtor i Buxhetit MFPT

Bazuar në neni 5 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe obligimet që dalin nga Organizatat Buxhetore bashkangjitur gjeni Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për Ministrinë e Shëndetësisë.

Me respekt,

## SEKTORI I SHËNDETËSISË

### 1. Misioni

Ruajtja e shëndetit, promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimi i shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive

### 2. Situata aktuale

Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2022 ka vazhduar angazhimin në menaxhimin e pandemisë COVID edhe përkundër situatës të qetë epidemiologjike. Ky angazhim është theksuar në zbatimin dhe monitorimin e masave të përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Paralelisht me mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike ka vazhduar vaksinimi i qytetarëve me vaksina kundër COVID-19, ndërsa së fundi janë siguruar dhe kanë filluar të aplikohen edhe dozat bivalente përforcuese (Pfizer) të siguruara përmes COVAX.

Ministria e Shëndetësisë ka siguruar dozat e mjaftueshme për vaksina kundër COVID-19 edhe për gjysmën e parë për vitin 2023, por është shqetësues fakti që përgjigja e qytetarëve për vaksinim vazhdon të jetë në nivelin me të ultë prej fillimit të procesit të vaksinimit dhe si rrjedhojë kemi skadim të afatit të përdorimit të vaksinave.

Është ri përtërirë zinxhiri i ftohtë i ruajtjes së vaksinave pas 20 vitesh me mbështetjen financiare të USAID si dhe është përruruar Depoja e re e vaksinave në IKSHPK, për të cilën janë investuar rreth 900 000 euro nga Ministria e Shëndetësisë.

Sa i përket legjislacionit është miratuar në Qeveri projektligji për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, gjithashtu është miratuar edhe udhëzimi administrativ 10/2022 për licencimin e profesionistëve shëndetësorë të huaj, Udhëzim Administrativ nr. 11/2022 përcaktimi i listës dhe llojet e pajisjeve ndihmëse që ofrohen falas për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim, Udhëzimi Administrativ 01/2022 për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale që nuk kanë paralele të autorizuara në Republikën e Kosovës dhe udhëzim Administrativ nr. 02/2022 kushtet në hapësirat e lejuara për pirjen e duhanit.

Ministria e Shëndetësisë gjatë tremujorit të katërt ka miratuar Planin për Stroke (Insulti cerebral), Planin për Fertilizimin të Asistuar Mjekësor, "Plani I Veprimit për shëndetin mendor pas COVID 19", "Plani i Veprimit për vaksinim 2022-2025", "Plani i Veprimit për hartimin e kritereve për regjistrin e banorëve në KPSH", "Plani I veprimit për furnizim të qytetarëve të RKS proteza, ortoza dhe materiale të tjera që ofrohen në ShKOP/ShSKUK, Planin për HIV, Planin për TB, Planin për Vaksinim dhe planin për kontrollin e mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse që paraqet dokumentin kyç mbi të cilin do të vlerësohet procesi i integritimit evropian për kapitullin 28. Ministria e Shëndetësisë në tremujorin e parë të këtij viti ka miratuar Planin strategjik për zbatimin e studimit të fizibilitetit përmirësimin e infrastrukturës fizike të institucioneve të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar 2023-2026 ka një kosto prej 41,423,675 euro.

Kosto shtesë prej 41,319,325 euro nuk është e ndarë me Ligjin e buxhetit nr. 08/L-193 për ndarjet buxhetore për vitet 2023 për sektorin e shëndetësisë dhe ligje tjera, përfshirë marrëveshje

ndërkombëtare për financim, prandaj duhet të gjinden format dhe alternativat për financim të planit të veprimit në koordinim me Ministrinë e Financave dhe transfereve.

Sa i përket standardeve në shëndetësi janë aprovuar Udhërrëfyeni Klinik: Menaxhimi dhe trajtimi klinik i COVID-19 (versioni 1.3) dhe UK "Parandalimi i transmetimit të HIV dhe AIDS nga nëna tek fëmija", UK "Mbikëqyrja në rast me HIV/AIDS". Në tërësi gjatë vitit 2022 janë hartuar dhe miratuar shtatë (7) Udhërrëfyeni klinik dhe pesë protokolle klinike. Gjithashtu janë pranuar, propozimet e reja për Planin për UPK për 2023.

Në kujdesin parësor shëndetësor, janë zhvilluar aktivitete në fuqizimin e kapaciteteve njerëzore në kuadër të programit specialistik të Mjekësisë familjare, si dhe ngritja profesionale përmes edukimit të vazhdueshëm profesional. Në kujdesin parësor shëndetësor, përmes grantit specifik për vitin 2023 janë aprovuar edhe 299 pozita për mjek familjar dhe infermierë. Gjithashtu në grantin specifik janë buxhetuar, vizitat në shtëpi për kujdes paliativ dhe vizitat për nëna dhe fëmijë në vlerë prej 3.2 milion euro. Ministria, për kujdesin parësor shëndetësor përmes projektit të Bankës Botërore ka siguruar pajisjet bazike për 26 komuna ndërsa për 12 komuna tjera janë siguruar përmes projektit AQH. Gjatë këtij viti në kuadër të vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë janë ofruar shërbime në 25 komuna me 34,142 vizita në shtëpi.

Sa i përket furnizimit me barna përqindja e furnizimit sipas planifikimit të institucioneve nga lista esenciale e barnave për vitin 2022 është rreth 70%, ndërsa me material shpenzues është rreth 90%. Kurse përqindja e furnizimit me insulina është 100%. Gjithashtu është aprovuar dhe zgjeruar mbulimi i trajtimit me terapi edhe nga lista komplementare (për fibrozë cistike). Janë siguruar barna për sëmundjet e rralla për (455) pacientë të regjistruar me sklerozë të shumëfishtë, (10) pacientë të regjistruar dhe diagnostikuar me sindromën Gaucher, (122) pacientë të regjistruar dhe diagnostikuar me Fibrozë cistike. Ministria gjithashtu ka siguruar terapinë për pacientët me terapi për TB (410) pacient me terapi antiretrovirale (51) dhe (264) pacientet me terapi mbajtëse me Metadon.

### 3. Objektivat zhvillimore

MSh, bazuar në Strategjinë kombëtare për zhvillim, Ministria e Shëndetësisë ka për qëllim të përmirësojë kualitetin dhe qasjen në shërbime shëndetësore dhe të promovojë jetë të shëndetshme që të rritet jetëgjatësia e popullsisë e të ulët vdekshmëria në përgjithësi, por vdekshmëria e foshnjave dhe nënave në veçanti.

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet përmes, këtyre objektivave strategjike:

- Përmirësimi i kualitetit dhe qasjes në shërbime shëndetësore;
- Mënyrë më e shëndetshme e jetesës;

Në kuadër të Planit kombëtar për shëndetësi janë paraparë **qëllimet zhvillimore dhe qëllimet strategjike** si në vijim:

**Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbime shëndetësore**

**Ruajtja dhe përparimi i shëndetit**

Qëllimet zhvillimore dhe qëllimet strategjike kanë paraparë treguesit e ndikimit dhe treguesit kryesor të rezultateve si në vijim

- Shkalla e shfrytëzueshmërisë së shtretërve spitalor dhe klinik
- Përqindja e popullsisë që nuk ka qasje në shërbime shëndetësore
- Përqindja e popullsisë që mbulohet nga sigurimet shëndetësore (të zbërthyer sipas publik/privat, moshës, urban/rural)
- Shpenzimet aktuale në shëndetësi si % e PBB (të brendshme (publike/private)/të jashtme)
- Përqindja e komunave që zbatojnë programin e shërbimit të vizitave në shtëpi
- Numri i mjekëve, infermierëve dhe personelit shëndetësor për 1,000 banorë
- Koha aktive për person (TUS)
- Mbulimi i plotë e imunizimit për moshën 24-35 muaj

Në kuadër të qëllimit zhvillimor **Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbime shëndetësore** janë paraparë këto masa strategjike:

- Zhvillimi i kornizës ligjore për riorganizimin e sektorit të shëndetësisë
- Funksionalizimi i mekanizmave për parandalimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse sipas vlerësimit të ECDC
- Funksionalizimi i mekanizmave për parandalimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve jo-ngjitëse
- Riorganizimi i shërbimeve shëndetësore
- Mobilizimi dhe menaxhimi i burimeve si dhe zhvillimi i kapaciteteve
- Zhvillimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor
- Avancimi i konceptit të Mjekësisë Familjare
- Riorganizimi i financimit shëndetësor
- Rritja e buxhetit për sektorin publik shëndetësor
- Zgjerimi i vizitave në shtëpi në komunat e RKS
- Mobilizimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Në kuadër të qëllimit zhvillimor **Ruajtja dhe përparimi i shëndetit** janë paraparë këto masa strategjike:

- Promovimi i aktivitetit fizik dhe mënyrës së shëndetshme të jetesës

- Përmirësimi i shërbimeve të vaksinimit për popullatën me theks tek grupet e cenueshme të shoqërisë

Tabela 1 : Trendët e financimit 2022-2023 dhe vlerësimet 2024-2026

Organizata buxhetore	Viti 2022 Shpenzimi	Viti 2023 Buxhetuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar
Numri i punëtorëve	1150	1,425	1,425	1,425	1,425
Paga dhe mëditje	10,776,522.31	11,782,273.92	17,895,234.81	18,401,138.35	18,817,276.79
Mallra dhe shërbime	17,970,476.06	27,752,014.46	28,168,598.66	28,350,714.66	28,532,964.66
Shpenzime komunale	182,601.85	281,348.00	295,000.00	305,000.00	316,000.00
Subvencione dhe transfere	3,778,896.63	4,513,805.00	3,461,346.00	2,803,056.00	1,208,318.00
Shpenzime kapitale	3,035,568.96	13,593,000.00	24,107,600	22,508,000	7,328,000
Burimet e financimit	35,744,065.81	57,923,866.38	73,927,779.47	72,367,909.01	56,202,559.45
Garantet qeveritare	28,893,430.63	57,922,441.38	73,927,779.47	72,367,909.01	56,202,559.45
Financimi nga të hyrat e AKP-së					
Të hyrat vetanake					
Financimet nga huamarrjet	4,614,821.84	14,311,619			
Financimi nga deficitet buxhetor (2%) - 04					
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	1,625,113.82	8,772,818			
Grantet nga Donatorët *	610,699.52	6,593,446.98			
<b>TOTALI</b>	<b>35,744,065.81</b>	<b>87,600,325.36</b>	<b>73,927,779.47</b>	<b>72,367,909.01</b>	<b>56,202,559.45</b>

- Me anë të Ligjit të Buxhetit Ministrisë së Shëndetësisë iu janë shtuar dy programe Instituti Special në Shtime dhe Shtëpia e Fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët janë buxhet 670,7647.00 dhe 80 të punësuar.
- Me ligjin e Buxhetit 2023 janë shtuar 50 numri i stafit për Ministrinë e Shëndetësisë;
- Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2022 ka të bartur nga viti në vit kredin nga Kreditori CEB e cila është marr për menaxhimin për COVID-19 nga viti 2020 dhe ka pjesë të pa shpenzuara për shkak që çmimi i produkteve farmaceutike ka rënë në krahasim me valën e pandemisë që ka qënë në vitet e kaluara dhe poashtu vaksinat janë kontraktuar me çmim më të ulët;

Në kuadër të buxhetit të 71300 janë të buxhetura vlera prej 21 mil euro për Listën Esenciale të Barnave vlerë kjo e cila është e ngjashme me vitin e kaluar, për shkak që Ministria e Shëndetësisë është në proces të rishikimit të Listës Esenciale të Barnave dhe në momentin që aprovohet si politikë do të vlerësohet nga grupet profesionale se a do të kemi nevojë për mjete shtesë dhe sa do të jetë vlera e tyre.

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të cilat organizata buxhetore nuk i ka përfshirë në Tabelën 1. (Vlerësimet 2023-2025)

Përshkrimi i Projektit	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Përshkrimi: Studimi i Fizibilitetit WBIF	13,392,053	11,434,350.00	16,597,272.00
<p>Ndërlidhja e politikës së re me Dokumentet Strategjike: Politika prioritare mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2023, Programin e Qeverisë 2021-2025, Planin Kombëtar për Zhvillim, Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Programin për Reforma në Ekonomi. Sa i përket riorganizimit të shërbimeve shëndetësore, situata aktuale tregon, që pajisjet e nevojshme mjekësore janë në thelb të disponueshme, por vetëm pjesërisht në funksion. Pajisjet mjekësore shpesh janë të dëmtuara ose të vjetruara dhe kërkojnë zëvendësim. Në përgjithësi 60% e totalit të pajisjeve janë funksionale, por më të vjetra se 10 vite, më pak se 10% e pajisjeve janë më të reja se 5 vite, përafërsisht 30% e pajisjeve janë jashtë funksionit. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i departamenteve mjekësore në spitalet e përgjithshme nuk përmbushin numrin minimal të pacientëve për organizim dhe trajtim efikas në fushën e kujdesit sekondar dhe terciar. Si rezultat, pacientët përballen me pritje, ndërkohë që kapacitetet nuk funksionojnë përgjithmonë. Me politikën e re synohet, që përmes zbatimit të planit të veprimit për zbatimin e studimit të fizibilitetit, të sigurohen pajisjet për të gjitha institucionet spitalore. Për optimizimin e trajtimit dhe efikasitetit të pacientëve, do të krijohen departamentet e specializuara në spitale. Me këtë qasje do të rritet ndjeshëm cilësia dhe siguria e shërbimeve dhe efikasiteti i investimeve në pajisje.</p> <p>Përveç kujdesit parësor dhe kujdesit emergjent, çdo spital duhet të zhvillojë 2 ose 3 specialitete për ofrimin e një trajtimi të pacientëve duke shfrytëzuar në mënyrë optimale resurset në dispozicion. Për këtë arsye, spitalet me numrin më të madh të pacientëve të shtruar në vitin 2017-2020 do të bëhen qendra e këtyre shërbimeve në Kosovë krahas QKUK-së. Spitalet e tjera nuk do t'i drejtojnë më këto departamente, por do t'i referojnë rastet me zgjedhje ose në Prishtinë ose në qendrat e tjera në vend. Ky model do të çojë në një përdorim më të madh të pajisjeve mjekësore.</p> <p>Me qëllim të adresimit të problemit me organizimin aktual të shërbimeve shëndetësore, do të zhvillohen disa faza. Disa pajisje, do të blihen dhe instaloheshin menjëherë pa punime rikonstruksioni në fazën e parë. Nga ana tjetër, ka pajisje tjera për t'u blerë, të cilat janë kryesisht të mëdha dhe duhet të vendosen brenda ndërtesës. Për këto pajisje duhet të kryhen punime paraprake rikonstruksioni të infrastrukturës aktuale me qëllim të adaptimit të hapësirave të duhura. Prandaj, zbatimi duhet të organizohet njëkohësisht në dy faza: Në veprime afatshkurtra, mund të blihen pajisje, të cilat mund të operohen menjëherë. Në veprimet afatmesme, punimet ndërtimore duhet të kryhen përpara se pajisja të instalohet.</p> <p>Së fundi, duhet të zhvillohen dhe zbatohen koncepte financimi, të cilat mundësojnë financimin e vazhdueshëm të mirëmbajtjes, pjesëve të rezervës dhe trajnimit e stafit.</p>			
<b>Total</b>	13,392,053	11,434,350.00	16,597,272.00
Numri i punëtorëve	8	8	8
Paga dhe mëditje	84,000.00	84,000.00	84,000.00
Mallra dhe shërbime	59,650.00	22,350.00	22,350.00
Shpenzime komunale			
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale	13,142,053.00	11,328,000.00	16,597,272.00
Burimet e financimit			
Grantet qeveritare			
Financimi nga të hyrat e AKP-së			
Të hyrat vetanake			
Financimet nga huamarrjet	13,392,053	11,434,350.00	16,597,272.00
Financimi nga deficitit buxhetor (2%) - 04			
Financimi nga Klauzola e investimeve -06			
Grantet nga Donatorët*			

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të cilat organizata buxhetore nuk i ka përfshirë në Tabelën 1. (Vlerësimet 2024-2026)

Përshkrimi i Projektit	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar
Server për ruajtjen e të dhënave të sistemit elektronik-BARNATARI /AKPPM	40,000.00	20,000.00	
<b>Total</b>	40,000.00	20,000.00	0
Numri i punëtorëve	0	0	0
Paga dhe mëditje	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	0	0
Shpenzime komunale	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0
Shpenzime kapitale	40,000.00	20,000.00	0
Sistemi i barnatarit është softëer elektronik që ofron shërbime efikase dhe të shpejta online për palet e interesit në AKPPM. Duke pas rëndësinë e zhvillimit të teknologjisë edhe cdo shërbim të kalohet në platformen online, BARNATARI ka nevojë të zhvillohet edhe me modulet e reja, ku për ruajtjen e të dhënave po ashtu na nevojiten edhe serveret si investim kapital për vitet 2024-2026			

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të cilat organizata buxhetore nuk i ka përfshirë në Tabelën 1. (Vlerësimet 2024-2026)

Përshkrimi i Projektit	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar
Dixhitalizimi i arkives qendrore të AKPPM-së	50,000.00	20,000.00	
AKPPM-ja duke u bazuar në rregulloren e menaxhimit zyrtar Arkivor për AKPPM si dhe listen me afatet e ruajtjes së dokumentacionit të AKPPM-së planifikon dixhitalizimin e dokumentacioneve që posedon që nga viti 2000 e tutje			
<b>Total</b>	50,000.00	20,000.00	0
Numri i punëtorëve	0	0	0
Paga dhe mëditje	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	0	0
Shpenzime komunale	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0
Shpenzime kapitale	50,000.00	20,000.00	0

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të cilat organizata buxhetore nuk i ka përfshirë në Tabelën 1. (Vlerësimet 2024-2026)

Përshkrimi i Projektit	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar
Zhvillimi i moduleve të reja-BARNATARI	36,800.00	20,000.00	20,000.00
Sistemi i barnatarit është softëer elektronik që ofron shërbime efikase dhe të shpejta online për palet e interesit në AKPPM. Duke pas rëndësinë e zhvillimit të teknologjisë edhe cdo shërbim të kalohet në platformen online,			

BARNATARI ka nevoj të zhvillohet edhe me modulet e reja, për përkrahjen e të gjithave shërbime në mënyrë elektronike			
<b>Total</b>	36,800.00	20,000.00	20,000.00
Numri i punëtorëve	0	0	0
Paga dhe mëditje	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	0	0
Shpenzime komunale	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0
Shpenzime kapitale	36,800.00	20,000.00	20,000.00

Tabela 3. Draft-parashikimi i te hyrave jo-tatimore të organizatës buxhetore 2024-2026

Emri I Organizatës Buxhetore	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar	Vlera totale e projektit (kur projekti është mbi periudhën 2024-2026)
Emri i projektit 1: Referenca ndaj Prioritetit Qeveritar / Dokumentit Strategjik:				
Totali	0	0	0	0
Kostoja e vlerësuar e projektit për investime*				
Burimi I financimit				
Financimi nga Klauzola e Investimeve				

Tabela 5. Draft-parashikimi i të hyrave jo-tatimore të organizatës buxhetore 2023-2025.

Organizata Buxhetore: Ministria e Shëndetësisë					
Kodi 5 shifror i të hyrës jo-tatimore:	Viti 2019 Arkëtimi	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Totali		-	-	-	-
		<i>Arsyetimi i vlerësimit 2021-2023</i>			
-----		<i>Arsyetimi i vlerësimit 2021-2023</i>			
-----		<i>Arsyetimi i vlerësimit 2021-2023</i>			

Ministria e Shëndetësisë nuk shpenzon të hyra.